



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Nr. 199 / 12 Prot.

Tiranë, më 28.02.2023

V E N D I M  
Nr. 51, Datë 28.022023

PËR  
“MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË KONTROLLIN E LARTË  
TË SHTETIT”

Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, neni 18, ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 25, si dhe Vendimit nr. 19, datë 31.01.2022, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në KLSH” i ndryshuar me Vendimin nr. 47 datë 28.02.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 19 datë 31.01.2022”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit Vjetor të Pranimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit me numër total **31** vende vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2023 në pozicione pjesë e shërbimit civil.
2. Vendet vakante janë përkatësisht:
  - Nëpunës Civil në nivelet drejtuese 4 vende;
  - Nëpunës civil pjesë e trupës audituese dhe drejtorive mbështetëse 27 vende.
3. Referuar juridiksionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit formimi dhe edukimi i individëve që do të rekrutohen nuk do të ketë kufizime por kryesisht do të përfshijë drejtimet si vijon:
  - Shkenca juridike;
  - Shkenca ekonomike;
  - Shkenca ekonomike/juridike;
  - Shkenca kompjuterike;
  - Shkenca shoqërore;
  - Shkenca sociale;
  - Histori-filologji;
  - Veterinari;
  - Agronomi;
  - Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
  - Kimi;

- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
  - Shkenca inxhinierike;
  - Arkitekturë;
  - Arkeologji dhe restaurime;
  - Gjeodezi;
  - Shkenca ekzakte;
  - Shkenca edukimi;
  - Etj.,
4. Procedurat për plotësimin e këtyre vendeve vakante do të zhvillohen në vijimësi duke iu referuar kuadrin ligjor për nëpunësin civil, ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe politikave të brendshme për menaxhimin e burimeve njerëzore.
  5. Njoftimet e detajuara për vendet vakante do të publikohen rast pas rasti në faqen e internetit në KLSH <https://www.klsh.org.al/> dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit <https://www.puna.gov.al/>.
  6. Të rekrutuarit nëpërmjet procedurave të përcaktuara nga legjislacioni për nëpunësin civil do të emërohen në departamentet e auditimit dhe drejtoritë mbështetëse rast pas rasti në varësi të politikave të brendshme për menaxhimin e burimeve njerëzore të KLSH-së si dhe nevoja që ka secili departament dhe drejtori për realizimin e planit vjetor të auditimeve dhe përmbushjen e detyrave funksionale.

**KRYETAR**

